

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 20.12.2024*

20.12.2024

Ora 12:34

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për rregullat e raportimit të veprimtarive publike në periudhën zgjedhore nga ana e institucioneve publike”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|----------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Znj.P. Doçaj, znj.B. Ereqi |
| • Parti | Politike: | S’ka |
| • OJQ: | | KRIIK |

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, zyrtarë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfaqësues të shoqërisë civile, përkatësisht të organizatës KRIIK. Në mbledhjen e sotme kemi një çështje në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektvendimin “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik nga ana e institucioneve publike para datës së zgjedhjeve”. Kolegë t’ju pyes nëse keni çështje jashtë rendit

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 20.12.2024*

të ditës për të diskutuar? Nuk ka. Fillojmë atëherë me rendin e ditës, znj. Doçaj një prezantim të shkurtër të projektvendimit.

Znj. P. Doçaj: Në lidhje me projektvendimin në shqyrtim përpara jush, ka të bëjë me “Rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik nga ana e institucioneve publike para datës së zgjedhjeve”. Një prezantim të shkurtër të vlerësimit të ligjshmërisë. Në referim të nenit 20 lidhur me aty, ku përcaktohen kompetencat e Rregullatorit për shqyrtimin, për të miratuar projektaktet me karakter normativ të përgatitur nga administrata e KQZ-së dhe anëtarë të tij për “Rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik nga ana e institucioneve publike para datës së zgjedhjeve”, po kështu dhe në referim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, aty ku parashikohen detyrimet e institucioneve publike qendrore dhe vendore dhe të tjerë për të raportuar në KQZ për veprimtaritë me karakter publik, duke vlerësuar bazën ligjore, vlerësojmë se nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim është në kompetencën e Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar. Një përmbledhje të shkurtër në lidhje me mënyrën se si është perceptuar, se si është renditur projektvendimi, është i renditur në pesë kre, ku seksionin e parë përcaktohet qëllimi, përkufizime dhe rregulla të përgjithshme. Në kreun e dytë parashikohen regjistrimin e subjekteve, në ndërfaqen elektronike të raportimit të institucioneve. Në kreun e tretë përshkruhen procedurat e raportimit në këtë ndërfaqe dhe në kreun e katërt përcaktohen shqyrtimet e raportimeve të tilla. Ndërsa në kreun e pestë më pas kemi dispozitat e fundit. Synimi i këtij projektakti ka të bëjë me përmirësimin dhe adresimin e të gjitha shqetësimeve, problematikave që janë hasur deri më sot për mënyrën se si është zbatuar neni 92 dhe se si janë raportuar veprimtaritë me karakter publik të institucioneve shtetërore, duke qenë se ka pasur disa problematika të hasura ndër vite, të paktën në këto katër vjet që është

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 20.12.2024*

administruar në mënyrë dinamike gjithë procesi, gjithë mekanizmi për të lehtësuar edhe aksesimin e institucioneve publike në këtë ndërfaqe dhe menaxhimin e këtyre raportimeve nga ana e KQZ-së. Në mënyrë të detajuar ne i kemi përshkruar në relacion se kush kanë qenë problematikat, të gjitha problematikat, por në mënyrë të detajuar disa nga problematikat që ka hasur ndërfaqja ka të bëjë me mosraportimin në kohë të institucioneve duke mos respektuar këtë afatin pesë ditor të raportimit, siç sanksionohet nga Kodi lidhur me veprimtaritë, tematikat e ndryshme të veprimtarisë, të cilat kanë qenë jo të plota dhe ka pasur problematikë në shqyrtimin e këtyre veprimtarive nga ana e KQZ-së dhe 2023, kemi pasur problematikën më të madhe mund të themi duke qenë se janë hasur vështirësi në aksesueshmërinë e kësaj ndërfaqeje, duke qenë pikërisht nga kjo problematikë nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kemi pasur një angazhim maksimal, për të krijuar ose për të ridizenjuar për të implementuar më saktë ose për të përmirësuar këtë ndërfaqe. Kemi pasur pikërisht nga Këshilli i Europës një mbështetje në lidhje me ridizenjimin e ndërfaqes, e kemi arritur këtë mbështetje nga ana e këtij institucioni dhe do të donim që më duhet të synojmë pikërisht atë përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të raportimit të veprimtarive publike në ndërfaqe. Në mënyrë më të detajuar është relacioni që i bashkëlidhet vendimit dhe mbetet për shqyrtimin tuaj. Faleminderit!

Znj.I. Nano: Faleminderit zonja Doçaj! Atëherë keni ndonjë pyetje për administratën? Po, z. Çakaj.

Z. M. Çakaj: Faleminderit zonja Kryetare! Atëherë unë ndoqa me vëmendje raportimin e drejtoreshës përkatëse. Kisha një pyetje, pështypjet mund t'i japin kolegët, disa çështje për diskutim. Së pari do të doja një informacion, aktualisht,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 20.12.2024*

sot funksionon ndërfaqja e raportimit? Nisur nga të gjithë problematikat që keni hasur ndër vite? Sepse propozohet të krijohet edhe me ndihmën e Këshillit të europës një ndërfaqe, një platformë e re, një modul i ri, i cili synon të përmirësojë të gjithë problematikën e hasur deri tani. Aktualisht funksionon një faqe ekzistuese e vjetër?

Znj. P. Doçaj: Aktualisht nuk funksionon.

Z. M. Çakaj: Qartë.


Znj. P. Doçaj: Ka pasur problematika që nuk funksionon, ka pasur problematika të karakterit teknik, është në punim e sipës, duke qenë se po ripunohet, për të adresuar të gjitha problematikat që janë konstatuar. Pra, që në hapjen e aksesëve nga ana e institucioneve dhe po përpunohet i gjithë procesi, të gjitha hallkat e procesit.

Z. M. Çakaj: Qartë.

Znj. P. Doçaj: Thjesht nuk funksionon.

Z. M. Çakaj: Një pyetje tjetër, në një situatë hipotetike që Komisioni Rregullator e shqyrton këtë, sot apo në vijim dhe e miraton këtë projektakt që sigurisht sot do të jetë në vijim. A mund të jeni gati, pra a mund të jetë gati kjo platforma e re, ndërfaqja e re elektronike e raportimit të institucioneve e cila propozohet për t'u miratuar dhe do të ndërtohet, a mund të jetë gati përpara datës 11 janar?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 20.12.2024*

Znj. P. Doçaj: Po do të jetë gati sepse është në proces punimi dhe janë, pra është e matshme, do të jetë gati.

Z. M. Çakaj: Qartë.

Znj. I. Nano: Në fakt kjo është shumë e rëndësishme, atëherë fillon afati katër mujor, madje pesë ditë përpara sepse fillojnë raportimet e para nëse do të ketë.

Z. M. Çakaj: Atëherë këtë diskutim, çështje për diskutim e kam me kolegët e Rregullatorit, atëherë projektakti i propozuar synon të ndërhyjë në vendimin nr. 9 të datës 24.12.2020, të cilin ne të gjithë e kemi miratuar me dakordësi, sigurisht kemi pasur goxha diskutime për atë vendim, megjithatë e kemi miratuar edhe pse ky vendim gjatë zbatimit të tij ka hasur problematika dhe paqartësi të ndryshme në vlerësimin tim ka funksionuar mirë. Nuk mund t'i jap notën shumë mirë po ka funksionuar mirë. Problematika në zbatimin e vendimit nr. 9 ka konstatuar dhe organi tjetër i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që është KAS-i dhe në analizat tona vjetore kemi diskutuar lidhur me mundësinë e ndërhyrjes në nenin nr. 9 për disa problematika të cilat janë evidentuar në shqyrtimin e ankesave apo vendimeve që ka marrë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe sigurisht ata kanë dhënë opinionin e tyre mbi vendimin nr. 9. Nga mënyra se si është formuluar vendimi këtë çështje e shtrova për diskutim dhe për kolegët, synohet që të materializohen aktet nënligjore të cilat janë formuar nga ligjvënësi neni 91 dhe neni 92 të Kodit Zgjedhor, në rastin konkret kemi të bëjmë me adresimin e normës së me rregullimin dhe detajimin e normës së parashikuar nga ligjvënësi në nenin 92 të Kodit Zgjedhor. Pra synohet të rregullohet, të përmirësohet procesi i raportimit të institucioneve të veprimtarive me karakter publik. Unë kam një problem të vogël

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 20.12.2024*

lidhur me mënyrën se si do të vijojmë ne për shqyrtimin e më pas miratimin e këtij projektakti. Në rastin konkret është propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve që të miratojmë këtë projektakt të ndarë, pra pjesën e raportimit ta veçojmë nga vendimi nr. 9 dhe ta miratojmë në një projektakt të ri. Në hipotezën se ne do të vepronim në këtë mënyrë, pra do të merrnim këtë vendim për problematika të nderuar kolegë në vështrimin tim do të ishte që vendimi nr.9 do të na rrinte, do të ngelej i parregulluar si në pikëpamje të teknikës legislative po edhe në pikëpamje të mbajtjes së aktit pasi vendimin nr. 9 ka të përfshirë dhe rregullat për raportimin. Pra, në vështrimin tim do të duhej që nëse do të ndërhyjmë te vendimi nr. 9, zgjidhja do të ishte në dy mënyra ose mënyra nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve do të kishim propozim për miratimin e dy projektakteve, pra projektakt për mënyrën e rregullimit të raportimit të veprimtarive të institucioneve ose dhe një projektakt tjetër do të ishte për identifikimin e veprimtarive të ndaluara, pra kategoritë e veprimtarive të ndaluara dhe çfarë nuk duhet të bëjnë institucionet publike gjatë periudhës katër mujore apo gjatë fushatës zgjedhore, neni 91 i Kodit Zgjedhor ose mënyra tjetër, ashtu siç e shtroi dhe çështjen për shqyrtim dhe diskutim përpara Komisionit Rregullator. Në hipotezën se ne ose Komisioneri e shikon të udhës të propozojë, po ne e gjejmë apo s'e gjejmë dakordësinë për ndryshime në vendimin nr. 9, për sa i përket kategorive dhe veprimtarive të ndaluara, në mënyrë që aktin që kishim, mirë apo keq ka funksionuar në gjykimi tim. Atëherë do të ishte e udhës që projektakti të vinte nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në formën e një propozimi për disa shtesa dhe ndryshime, sigurisht me këtë përmbajtje ose me propozimet, sugjerimet e kolegëve për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Kështu që do t'ju lutesha të nderuar kolegë, ta shikojmë në

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 20.12.2024*

këtë këndvështrim dhe sigurisht duke marrë një opinion dhe nga administrata.
Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit! Po zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Në vijim të fjalës së kolegut Çakaj dhe asaj çfarë ai parashtrori në lidhje me rëndësinë e këtij akti, në lidhje me argumentat mbi këtë akt, në lidhje me dispozitat me të cilat lidhet ky akt, nuk mund të rri pa filluar nga a-ja, nga gërma “a” alfabetike e gjithë këtij procesi ku jemi, ku ndodhemi sot, qoftë nga ana formale, qoftë nga ana procedurale, pra relacionit tuaj. Kur ne na vini në lëvizje, pra Komisioneri përmes jush, në këtë rast na ka vënë në lëvizje duhet që së pari të merrnit masa dhe t’i kishit marrë firmën Komisionerit në relacionin tuaj, kjongra ana formale dhe këtë duhet ta korrigjoni në momentin kur do të kemi, shpresojmë të kemi një akt. Së dyti, relacioni juaj edhe pse ne jua kthyem relacionin për të na dhënë argumenta të tjerë dhe për të na dhënë argumenta bindës, që përse ne duhet të vihemi në lëvizje dhe përse ne duhet të marrim në shqyrtim një akt të ri, i cili buron nga akt ekzistues, si pjesë e integruar ose si pjesë e fraksionuar e aktit, pra vendimit nr.9, të datës 24.12.2020. Pra këto argumenta edhe pse ju morët sërish kohë dhe sollët një relacion të ri, përsëri mungojnë. Më shumë kemi për të përdorur sugjestionimin nga ana jonë në email, në qoftë se e keni parasysh që ju thamë arsyet, cilat janë arsyet që ju, pse po viheni në lëvizje, pse kërkonit këtë ndryshim sot, kush kanë qenë faktorët, çfarë analize keni bërë ju situatës, si ka raportuar subjektet që adreson ose i ngarkon me përgjegjësi ligji apo Kodi Zgjedhor? Jo vetëm që nuk e patëm këtë në relacionin e dytë por si të thuash ishte një relacion i cili thjesht nxori në pah faktin që ju doni një modul të ri. Këtu po e marrim vesh që ky modul i ri, fatmirësisht nuk qenkërka prokurim ku çenohet


*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 20.12.2024*

buxheti i shtetit po dhe qenkërka dhuratë dhe ky modul i ri nuk paska funksionuar që nga viti 2023. Më lind pyetja natyrshëm, nuk gjenit më përpara shumë pak minuta kohë sa të na informonit që shiko kjo faqe nuk paska funksionuar, për hir të modulit që nuk funksionon në KQZ. Pra dhe këtu të ndanit, ka qenë faji i KQZ-së apo faji i atyre që kanë dashur të raportojnë, nuk kanë arritur dot të raportojnë ose atyre që s'kanë dashur të raportojnë. Pra, si rregull në çdo dosier që do të krijoni ju për të ardhur me këtë rast me një propozim të caktuar bëhet një analizë, analizë bindëse e cila na vë në një diskurs më konstruktiv dhe në të njëjtën kohë na çon drejt miratimit të aktit. Pra kur gjejmë një argument patjetër do merrni miratimin e aktit. Ky akt, ky draftakt jo vetëm që nuk vjen të propozohet nga Komisioneri, siç do t'i kishte hije por nuk është, nuk shoh që është as Sekretari i Përgjithshëm, zëvendësuesi i tij sipas rregullores. Në këtë rast merrni ju përsipër që ta argumentoni ose relatoni. A jeni ju në gjendje t'i jepni përgjigje për vitet pararendëse kur ndoshta ju në KQZ, nuk e di se kur keni filluar marrëdhëniet e punës, keni filluar më vonë se 2020 kam përshtypjen dhe nuk dini feedback-un e ecurisë së këtij akti. Po të ishte sot Komisioneri ne do t'i shtronim pyetjen, si ka ecur, si janë sjellë institucionet me aplikimin e kësaj pjese të vendimit nr.9? Pra detyrimit për raportim, ne këtë nuk e kemi. Në kuadër të asaj çfarë ngriti kolegu, i bashkohem katërçipërisht dhe në qoftë se ne do shikojmë për hir të një moduli, pra qenkërka shumë sensitiv moduli dhe jo përgjegjësia që ata kanë për raportimin , do shikojmë një pjesë të vendimit, atëherë unë ju ftoj që ju të rishikoni në tërësi vendimin nr. 9 dhe të merrni kohën tuaj për ta riparë këtë pjesë të aktit, do të doja që ky të vinte në tërësi për plotësimin apo ndryshimin apo shtesa të tjera që i përshtaten terrenit, kohës dhe të gjitha analizave të bëra nga KQZ-ja deri tani, pra të vendimit 9. Ky është në suazën e një, si të thuash qasje që unë kam tani për

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 20.12.2024*

momentin në raport me çfarë dëgjova dhe çfarë kam parë nga përmbajtja e këtij relacioni dhe projektvendimi. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Në fakt unë kam një mendim që e kam ndarë herët, që në kohën që miratonim vendimin 9, që neni 91 dhe 92 kanë dy autorizime të ndryshme dhe do të duheshin dy akte të ndryshme, i pari që do të lidhej me kqepërdorimin e burimeve shtetërore, i dyti me raportimin. Gjithsesi së bashku kemi miratuar një vendim pikërisht para katër vitesh, në 24 dhjetor të 2020, vendimin 9, i cili i përmban të dyja këto aspekte, janë rregulluar të dy këto aspekte dhe ato që parashikohen nga neni 91 dhe ato që parashikohen nga neni 92. Jemi në këtë situatë ku na ka ardhur një propozim i cili në thelb ndryshon vendimin 9, por në fakt gati-gati dhe atë të zhveshur nga një pjesë e mirë e dispozitave. Për shkak të këtyre diskutimeve që lindën ju propozoj kolegëve dhjetë minuta pushim që dhe të diskutojmë nga afër me administratën, e cila do të duhet të marrë një autorizim përkatës për atë se si duhet të veprojë dhe rikthehem pas dhjetë minutash. Jeni dakord? Faleminderit!

Rifillon seanca

Ora 13:08

Znj. I. Nano: Rifillojmë mbledhjen, bëme një pushim të shkurtër për t'u konsultuar me administratën, lidhur me diskutimet që u bënë në mbledhje. Zonja Doçaj keni diçka mbas këtyre diskutimeve për të thënë, për këto çështjet lidhur mundësinë e ndryshimit të vendimit nr.9?

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 20.12.2024*

Znj. P. Doçaj: Nisur dhe nga çka u diskutua në këtë mbledhje por edhe sugjerimeve që ky Komision dha, patjetër që ne ndoshta do të duhet konstatojmë dhe në formën e kërkuar nga ana juaj, jo si një akt më vete por si ndryshimi i dispozitave të vendimit nr. 9 të Rregullatorit.

Znj. I. Nano: Kolegë keni diçka? Për kohën?

Znj. P. Doçaj: Brenda ditës së sotme do të kemi patjetër një akt të ndryshuar.

Znj. I. Nano: Pra do të na vijë akti i ri për shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.9? Pra tërheqim këtë akt dhe sjellim aktin e ri për shtesa dhe ndryshime.

Znj. P. Doçaj: Të kërkuar nga ana juaj.

Znj. I. Nano: Dakord.

Znj. H. Vukaj: Duke qenë se administrata reflektoi në këtë pikë dhe ne besoj që biem dakord sepse kërkesat tona ishin që të akomodohej, jo vetëm përmbajtja e nenit 92, në përshtatje me kushtet logjistike etj., por në të njëjtën kohë edhe neni 91. Kështu që unë kërkojn që përmes shtesave dhe ndryshimeve, ju të shikoni mundësinë e vlerësimit të situatës edhe për pjesën e akomodimit më të mirë në përputhje me analizën që ka arritur KQZ-ja deri tani për funksionimin mirë ose keq të atyre krerëve që kanë të bëjnë me veprimtaritë e ndaluara.

Z. M. Çakaj: E thënë më shkurt, pra ju vijoni me shtesat, propozimet brenda ditës së sotme, për raportimin, pra rregullat për raportimin dhe ndërfaqen, ta

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 20.12.2024*

akomodojmë në vendimin nr. 9, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, sot, nesër, por të mos ngelet pas dore sepse ka qenë dhe një zotim nga të gjithë analizën zgjedhore, ka qenë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë zotimin që po diskutet shumë shpejt do të kemi një propozim për ndryshimin e vendimit nr.9, dispozitave të vendimit nr. 9, për sa i përket, pra përmirësim, sqarim i gjithë problematikave çfarë kemi pasur, për sa i përket keqpërdorimit të burimeve shtetërore dhe ku llogariten dhe veprimtaritë e ndaluara, kështu që do të kërkonim në vijim të ecet, të shtyhet pra ky proces në mënyrë që mundësisht përpara datës 11 janar të kishim një propozim konkret pranë Komisionit Rregullator. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Keni diçka tjetër zonja Vukaj?

Znj. H. Vukaj: Meqenëse erdhëm në këtë mbledhje dhe pati një rëndësi ky shqyrtim për të akomidimit më mirë të situatës. Kujtohem që në mbledhjen e shkuar kam lënë disa porosi për administratën, e cila mund të më japë një informacion nëse mundet dhe ku ndodhet me shkresat që kam kërkuar dhe sidomos me panoramën e datës 10.11.2024 që duhet të vinte nga Gjendja Civile dhe jo të vinte përtej afateve, jo të vinte në dhjetor, siç ai e solli sepse impakton në qoftë se do të kemi një panoramë ndryshe. E keni çuar ju këtë shkresë?

Znj. P. Doçaj: Për cilën shkresë ju lutem?

Znj. H. Vukaj: DPGJC-ja solli një informacion mbi popullatën dhe mbi bazën e popullatës.

Znj. P. Doçaj: Në lidhje me dy aktet e miratuara?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 20.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Po, në lidhje me dy aktet e miratuara. Pra kam kërkuar herën e fundit që të kem këtë panoramë nga DPGJC-ja, jo vetëm unë, do t'i vihet në dispozicion të gjithëve.

Znj. P. Doçaj: Do të pyes drejtoreshën përkatëse dhe ndoshta nesër kur të bëjmë mbledhjen.

Znj. H. Vukaj: Po, Daniela ka qenë në tryezë, kështu që referuar asaj po njëkohësisht më duhet të shoh shkresën që i keni nisur.

Znj. P. Doçaj: Po do t'ia referojmë asaj.

Znj. I. Nano: Atëherë përpara se të mbyllim mbledhjen, ajo çka u vlerësua sot këtu është akti që ka ardhur do të tërhiqet për t'u akomoduar si shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 9. Nga ana juaj na u tha që do të sillet po sot në mënyrë që ne të organizojmë një mbledhje tjetër nesër. Do të luteshim në një kohë sa më të shkurtër, në mënyrë që të bëjmë njoftimet përkatëse për mbledhjen e ditës së nesërme. Atëherë mbledhjen e deklaroj të mbyllur, meqë s'kemi çështje të tjera në rendin e ditës.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

